



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

GUSHT 2025

Tiranë më 31.08.2025

1.	01.08.2025	1-Pse Ishmi është lumi më i ndotur në Shqipëri dhe Evropë, cilët janë shkaktarët dhe cilat janë disa nga pikat më të ndotura përgjatë rrjedhës? A	07.08.2025	<p>1-Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore nga AKM ka si qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara, duke siguruar një bazë të dhënash të cilat përdoren në hartimin e Raportit të Gjendjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit.</p> <p>Lumi Ishëm monitorohet ne tre stacione: Ura Rinas, Ura e Gjolës dhe Ura Salmer.</p> <p>Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e monitoruar, vlerësojmë se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajtuara sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë.</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	------------	--------

		<p>ka elemente të dëmshëm për shëndetin në të?</p> <p>2-Pse ndotja e Ishmit është një problem që ka zgjatur për vite me radhë? A keni patur mjetet e duhura për menaxhimin e situatës, çfarë ka munguar?</p> <p>3-Sa bashkëpunues janë banorët e zonave përgjatë lumit për mbajtjen e pastër? A janë penalizuar në raste të caktuara? A është baza ligjore e</p>		<p>Baseni Ishëm – Erzen klasifikohet në Klasën V – Gjëndje e keqe.</p> <p>2-AKM delegon shkresat në institucionet përgjegjëse për të marrë masa pasi roli ynë është monitorimi dhe identifikimi i ndotjes duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.</p> <p>Pyetjet nga 3-8 janë jashtë fushës së veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, referuar VKM-së Nr.568/2019.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>mjaftueshm e për të lehtësuar punën tuaj?</p> <p>4- Sa bashkëpunu- ese janë kompanitë në këtë zonë? A derdhin ato mbetje në lumë? Si keni reaguar? Po sa i përket monitorimit, si keni vepruar?</p> <p>5-Cilat do të ishin zgjidhjet e mundshme për pastrimin e ndotjes? Impiantet? Ndërgjegjësi mi i banorëve dhe kompanive në zonë? Monitorim</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>elektronik? Tjetër? Për sa kohë do të pastrohej po të nisnin këto zgjidhje?</p> <p>6-A ka një një strategji për ta zgjidhur përfundimisht situatën? A ka një plan? Cila/cili është ajo/ai?</p> <p>7-A është e nevojshme ngritja e një grupi taskforce me përfshirjen e gjithë aktorëve: ministria /agjencitë/ banorë/ NGO etj. për të menaxhuar situatën dhe pastruar</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>përfundimisht lumin Ishëm?</p> <p>8-Pse Impianti i Kasharit nuk është bërë funksional? A mundet ai të funksionojë si ai i Korçës? A mund të ngrihen impiante të tjera të përpunimit të ujërave të zeza në zonë me qëllim që të mos derdhen të pafiltruara në Ishëm?</p>				
2.	01.08.2025	Jam banor i qytetit Tiranë, na janë vënë tela të internetit	01.08.2025	Në përgjigje të ankesës suaj, Ju bëjmë me dije se problematika në fjalë nuk bën pjesë në fushën e përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbështetur në VKM-në Nr.568 datë 17.07.2019 “ <i>Për Krijimin, Mënyren e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit</i> ” .	Përfunduar	Nuk ka

		dhe telefonave në fasadën e ballkonit dhe apartamentit ku duhet të drejtohem që të hiqen lutem?		Në lidhje me pretendimin tuaj, lutemi ti drejtoheni Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit pranë Njësisë Administrative Tiranë ku ju keni vendbanimin, referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" nenet 63 dhe 78 si dhe Ligjit Nr.9918/2008 "Për komunikimet elektronike në RSH" neni 7 dhe 8.		
3.	05.08.2025	Dëshiroj të paraqes një ankesë për një furrë buke që ndodhet në katin përdhe të pallatit tonë, kjo furrë shkarkontym dhe erëra të rënda, të cilat futen në banesat tona dhe krijojnë ndotje ajri dhe shqetësim serioz për shëndetin dhe jetesën.	05.08.2025	Në përgjigje të emailit tuaj, në lidhje me shqetësimin e ngritur për ndotjen e ajrit dhe erërat e pakëndshme të shkaktuara nga furra e bukës e ndodhur në katin përdhe të pallatit në adresën Rruga *****, ju informojmë si më poshtë: Në zbatim të VKM-së Nr. 568 datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", Drejtoria e Inspektimit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit kryejnë inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe të kërkesave ligjore, sipas fushës së kompetencës. Referuar Shtojcës 1 të ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448 datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, përcaktohen aktivitetet që klasifikohen si me ndikim në mjedis dhe që duhet të pajisen me leje mjedisore të Tipit A apo B. Aktiviteti i përmendur në ankesën tuaj nuk bën pjesë në listën e këtyre aktiviteteve dhe, për rrjedhojë, nuk është objekt inspektimi nga ana jonë. Megjithatë, në zbatim të pikave a, b, c dhe ë të nenit 4 të ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", ju sugjerojmë që të paraqisni ankesën pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, si institucioni përgjegjës për adresimin e shqetësimeve që lidhen me ndotjen nga aktivitetet tregtare në zonat e banuara.	Përfunduar	Nuk ka

		Kërkoj nga ana juaj që të dërgohet një inspektim në vendngjarje dhe të merren masat për ndalimin e ndotjes.				
4.	06.08.2025	Vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me aktivitetin e një kompanie që operon si gurore në zonën e Postribës, Shkodër. Konkretisht, kërkojmë informacion për kompaninë "B*** C***" sh.p.k. – ose	14.08.2025	<p>Referuar kërkesës suaj ju informojmë se Lejet me Kod III.1.B, III.1.C dhe licencat me kod III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB.</p> <p>Bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.</p> <p>Neni 14, Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve citohet:</p> <p>1. Çdo licencë/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.</p> <p>2. Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p>nënkontrakt- orë të saj që mund të jenë duke operuar në të njëjtën zonë – si më poshtë: 1. A ka kjo kompani një leje mjedisore aktive për zhvillimin e aktivitetit të gurores në zonën në fjalë? 2. Nëse jo, ju lutem konfirmoni: A është pezulluar apo revokuar leja mjedisore e kësaj kompanie? Datën dhe vendimin zyrtar të pezullimit apo revokimit (numër</p>		<p>13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Link-u i regjistrin kombëtar pranë QKB-së: https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</p> <p><i>Ju orientojmë se në faqen zyrtare të Institucionit të AKM është e publikuar një listë me leje dhe licenca e cila është e mbajtur në mënyrë manuale. Më poshtë link-u:</i></p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/</p> <p>https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/</p> <p><i>Për një informacion më të saktë ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të licencave dhe lejeve siç e përcakton dhe ligji!</i></p> <p>Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, na bëhet me dije se : Gjatë verifikimit në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe nga planet mujore të inspektimeve të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit rezulton që subjekti "B**** C****" është pajisur me leje mjedisore të tipit B për aktivitetin industria minerare , në vendndodhjen Vendburimi Rasek, Mes, Postribë, Shkodër, e cila rezulton aktive.</p> <p>Gjatë inspektimeve të ushtruara nga trupat inspektuese të Agjencisë Rajonale Shkodër, Lezhë, Kukës, nuk janë konstatuar shkelje të kushteve të lejes mjedisore.</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>protokoll, institucion vendimmarrës).</p> <p>3. Arsyet e pezullimit/revokimit (nëse ka ndodhur).</p> <p>4. A është konstatuar nga inspektorët e mbrojtjes së mjedisit apo një organ tjetër mbikëqyrës se kompania apo kontraktorë të saj po vijnë në zonë pavarësisht mungesës së lejes?</p> <p>5. A janë marrë masa ndëshkimore për rast të ushtrimit të aktivitetit në kundërshtim me</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		legjislacion-in mjedisor në këtë zonë?														
5.	18.08.2025	<p>1- A dispononi raporte për cilësinë e ajrit në qytetin e Durrësit ? Si ka rezultuar? Ju lutem na vini në dispozicion të dhënave</p> <p>2- Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë për ndotjen e ajrit në këtë bashki? - Në sa pika matet cilësia e ajrit në këtë qytet dhe sa herë në vit? A janë të mjaftueshme? Ju lutem na vini në dispozicion</p>	27.08.2025	<p>1-Raportet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban janë të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM https://akm.gov.al ku publikohet Raporti Gjëndjes në Mjedis i cili publikohet cdo fillim viti nga AKM.</p> <p>2- Në qytetin e Durrësit tejkalime kemi për grimcat e pluhrit kryesisht . Nga monitorimi ndër vite që AKM ka kryer rezultoni që shkak kryesor është trafiku ,ndertimi dhe në qytetin e Durrësit ndikon edhe kripa e detit. Kjo është vërtetuar edhe gjatë monitorimit në periudhën e pandemisë, ku është vënë re një ulje e të gjithë treguesve që monitorohen .</p> <p>3-Në qytetin e Durrësit kemi një stacion monitorimi.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Stacionet</th> <th>Vendndodhja</th> <th>Treguesit</th> <th>Koordinatat</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Durrës</td> <td>Oborri i shkolles “Jusuf Puka”</td> <td>PM10/PM2.5, SO₂ , NO₂ , O₃, CO, BTEX</td> <td>41°18’50.26”N 19° 26’57.44”E</td> </tr> </tbody> </table> <p>Treguesit që maten janë ata që kërkohen nga BE, për një monitorim më gjithëpërfshirës mund të kishte dhe stacione të tjerë duke pasur parasysh dhe numrin e popullsisë së qytetit.</p> <p>4- Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion që kryen monitorim dhe jep rekomandime. Strategjite për përmirësimin e cilësisë së ajrit urban i marrin institucionet vendore dhe lokale.</p> <p>5-</p> <table border="1"> <tr> <td>Buxheti per mirembajtje/vit</td> <td>Lekë</td> </tr> </table>	Stacionet	Vendndodhja	Treguesit	Koordinatat	Durrës	Oborri i shkolles “Jusuf Puka”	PM10/PM2.5, SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX	41°18’50.26”N 19° 26’57.44”E	Buxheti per mirembajtje/vit	Lekë	Përfunduar	Nuk ka
Stacionet	Vendndodhja	Treguesit	Koordinatat													
Durrës	Oborri i shkolles “Jusuf Puka”	PM10/PM2.5, SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX	41°18’50.26”N 19° 26’57.44”E													
Buxheti per mirembajtje/vit	Lekë															

	litën e pikave ku matet cilësia e ajrit në këtë qytet - Cilat janë strategjitë që institucioni juaj ka ndërmarrë në funksion të përmirësimit të cilësisë së ajrit? - Sa është buxheti në dispozicion për mjedsin dhe a keni fonde në dispozicion për këtë zë në vecanti? Fondet të jenë për 5 vitet e fundit.						
				2021	14400000		
				2022	10307722		
				2023	8200000		
				2024	10300000		
				2025	36000000		